



BULETINI MUJOR

KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM

IMRI AHMETI: Me mbështetjen e popullit amerikan që përmes fondit Sfidat e Mijëvjeçarit, financuan projektin e renovimit të tërsishëm, fasadimin dhe izolimin e objekteve shumë banesore në Lipjan



Ky projekt është i rëndësishëm sepse ka impakt në uljen e shpenzimeve dhe gjithësesi do të ngris standardin dhe mirëqenien e banorëve.

Për qytetarët e Lipjanit është mbështetje e veçantë dhe e rëndësishme, ne kemi shprehur zotimin tonë për mirëmbajtjen e investimeve në këtë fushë së bashku me pronarët e banesave në ndërtesat që janë në këtë projekt të efijencës së energjisë.

Komuna e Lipjanit është zgjedhur si komuna e parë në nivel vendi për ta implementuar këtë projekt.

Në Shalë janë asfaltuar disa rrugica, është punuar në instalimin e ndriçimit publik dhe është bërë renovimi i nyjeve sanitare në shkollë.



Së shpejti qytetarëve të Komunës së Lipjanit do t'u ofrohen shërbime juridike falas

Pas takimeve të zhvilluara nga Kryetari Imri Ahmeti me përfaqësuesit e Agjencisë për Ndihmë Juridike që edhe qytetarëve të Komunës së Lipjanit t'u ofrohen shërbime juridike falas sot nënkryetari i Komunës së Lipjanit Fauz Xhemajli ka nënshkruar marrëveshje bashkëpunimi me drejtoreshën e kësaj Agjencie, Anita Alaj Kalanderi.



Komuna e Lipjanit ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021-2022, kështu ka bërë të ditur Drejtoresha e Arsimit Elmaze Behluli.

Ajo ka theksuar se ka përfunduar Dezinfectimi i të gjitha objekteve shkollore në Komunën e Lipjanit, si dhe është bërë pajisja me dezinfektues, maska dhe dorëza për të gjitha shkollat.



Komuna e Lipjanit ka bërë të gjitha përgatitjet për fillimin e vitit të ri shkollor 2021-2022, kështu ka bërë të ditur Drejtoresha e Arsimit Elmaze Behluli.

Ajo ka theksuar se ka përfunduar Dezinfektimi i të gjitha objekteve shkollore në Komunën e Lipjanit, si dhe është bërë pajisja me dezinfektues, maska dhe dorëza për të gjitha shkollat.



342 maturant lipjanas iu nënshtruan Provimit të Matures Shtetërore në afatin e dytë

**Ky provim është organizuar në 3 qendra të testimit me
gjithësej 342 nxënës që i janë nënshtruar testit.**

**Për shkak të situatës së krijuar nga pandemia COVID-19, testi
i maturës është organizuar duke respektuar masat mbrojtëse
të rekomanduara nga Instituti Kombëtar i Shëndetësisë
Publike të Kosovës (IKSHPK)**



Pasurohen bibliotekat e shkollave të Lipjanit me shumë tituj të rinjë të lektyrave

Edhe tri shkolla të Komunës së Lipjanit në Baicë, Dobrajë e Smallushë janë pasuruar me tituj të ndryshme të lektyrave, Drejtoresha Arsimit Elmaze Behluli është shprehur se do të vazhdohet edhe më tutje me furnizime të tilla për bibliotekat e shkollave.



Miratohet propozim vendimi mbi transferin dhe rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2021

Kuvendi Komunal i Lipjanit nën udhëheqjen e Kryesuesit Daut Azemi është mbajtur seancë e jashtëzakonshme me vetëm një pikë të rendit të ditës.

Pas diskutimeve me shumicë të votave sot është bërë miratimi i propozim vendimit mbi transferin dhe rialokimin e mjeteve të buxhetit për vitin 2021.



Përfundon asfaltimi i rrugës Lluga-Radevë

Ka përfunduar asfaltimi i rrugës Lluga-Radevë një projekt ky shumë i rëndësishëm për banorët që jetojnë në këtë pjesë.

Rregullimi dhe asfaltimi i rrugës Lluga-Radevë do të mundësoj banorëve qasje më të lehtë për të arritur në destinacionin e duhur, Komuna e Lipjanit tashmë ka edhe një rrugë më shumë që lidhë me komunat fqinje.



Në vazhdën e realizimit të shumë projekteve në teren, së fundi ka filluar edhe realizimi i projektit rikonstruimi i rrugës në fshatin Llugaxhi, ku përveq riasfaltimit të rrugëve do të bëhet edhe shtrirja e ndriçimit publik.

Me përfundimin e këtij projekti qytetarët do të kenë kushte më të mira, sidomos në aspektin e sigurisë.



Ditëve të fundit kanë filluar punimet në zgjerimin e rrjetit të ndriçimit publik nga qyteti i Lipjanit deri tek rrethrrrotullimi Banullë- Janjevë.

Shtirja e ndriçimit publik është duke u shtuar çdo ditë e më shumë përveç qytetit edhe në venbanimet e tjera, projekte këto të mirëpritura nga ana e qytetarëve të cilat do të ndikojnë në rritjen e sigurisë gjatë qarkullimit të tyre përgjat këtyre rrugëve.



Me një dinamikë të mirë po vazhdojnë punimet edhe në projektin tjetër për shtrirjen e rrjetit të ndriçimit publik nga fshati Llugaxhi deri në Gadime në të cilin projekt do të përfshihen edhe ndriçimi i lagjes Lekaj, Ejupi dhe Aliu.


Një projekt mjaft i rëndësishëm që do të ndikojë në rritjen e sigurisë së qytetarëve gjatë qarkullimit të tyre përgjatë këtyre rrugëve.



Për një siguri më të mirë për banorët e fshtrave Ribar i Madh dhe Zllakuqan gjatë qarkullimit të tyre Komuna e Lipjanit ka ndërmarrë veprime duke filluar me implementimin e projektit për instalimin e ndriqimit publik edhe në këto dy venbanime.



Kanë nisur punimet në shtritjen e ndriçimit publik edhe në fshatin Kraishtë



Është bërë renovimi i hapësirave të objektit të Stomatologjisë dhe ish-objektit i Pulmologjisë në QKMF-Lipjan.

Edhe njëherë kjo dëshmon përkushtimin e Komunës së Lipjanit për shërbimin sa më cilësor dhe me dinjitet, për mirëqenjen e qytetarëve tanë.



Mbahen dëgjime publike lidhur me Planifikimin e Buxhetit për vitet 2022-2024

Në Komunën e Lipjanit kanë filluar dëgjetimet publike lidhur me Planifikimin e Buxhetit për vitet 2022-2024

Me këtë rast, Drejtori për Buxhet dhe Financa, Latif Ramadani ka pranuar të gjitha kërkesat që kanë dal nga këto takime, po ashtu Drejtori Ramadani ka inkurajuar qytetarët që të marrin pjesë sa më shumë në këto takime sepse kanë rendësin e veçantë dhe është mundësia më e mirë për përfshirjen e kërkesave të qytetarëve në në planifikim të buxhetit për vitet e ardhshme.



Në Komunën e Lipjanit edhe kanë vazhduar dëgjimet publike lidhur me Planifikimin e Buxhetit për vitet 2022-2024



Në Lipjan Shënohet Dita Ndërkombëtare e Rinisë

Në hapësirat e Bibliotekës në qytetin e Lipjanit sot është mbajtur Konferencë lokale e të rinjëve me temën "E ardhmja qëndron tek të rinjtë" në kuadër të Planit të Veprimit Rinor Lokal



**Koncerti për bashkëatdhetarët tanë!
Faleminderit, jemi mirënjohës gjithmonë!**



LIPJAN



KOMUNA E LIPJANIT - ZYRA PËR INFORMIM



BULETINI MUJOR



RR. SHQIPËRIA NR: 28 14000 LIPJAN, KOSOVË

TEL: 038 200 41 508

THIRR PA PAGESË 0 800 14 000

EMAIL: INFOKOMUNA.LIPJAN@RKS-GOV.NET